



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.38

21 prill

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MPPT dhe MSH nr. 4, datë 19.3.2012	Për organizimin e kursit të trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor.....	2123
Udhëzim i MASH nr. 6, datë 6.4.2012	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 41, datë 8.12.2009 “Për procedurat dhe kriteret e njohjes së diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”.....	2129
Udhëzim i MBUMK nr. 7, datë 19.3.2012	Për përdorimin e aditivit ushqimor “E 960 Steviol Glycoside” në produktet ushqimore.....	2131
Vendim i BSH nr. 16, datë 13.3.2012	Për miratimin e rregullores “Për kredinë për mbështetje me likuiditet”.....	2137
Vendim i ERE nr. 23, datë 24.2.2012	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregullat e tregut të energjisë elektrike.....	2143
Vendim i ERE nr. 30, datë 26.3.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror...	2146
Vendim i ERE nr. 31, datë 26.3.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror..	2146
Vendim i ERE nr. 32, datë 26.3.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	2147
Vendim i ERE nr. 33, datë 26.3.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2148

Vendim i ERRU nr. 2, datë 18.1.2012	Për rinovim licence sha ujësjellës kanalizime Librazhd.....	2149
Vendim i ERRU nr. 4, datë 29.2.2012	Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë.....	2149
Vendim i ERRU nr. 5, datë 29.2.2012	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a., “UK Librazhd”	2150
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Kapllan Kapllani.....	2151
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit, Kostë Konomi.....	2151

UDHËZIM
Nr. 4, datë 19.3.2012

**PËR ORGANIZIMIN E KURSIT TË TRAJNIMIT PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË
SHPEJTË MJEKËSORE NË RAST AKSIDENTI RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 119, 120 dhe nenit 121 pika 6 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Ministri i Shëndetësisë

UDHËZOJNË:

Neni 1

Kursi i trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor bëhet nga Kryqi i Kuq Shqiptar nëpërmjet degëve përkatëse bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky kurs i organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ka për qëllim përgatitjen e personave të interesuar për pajisje me leje drejtimi të mjetit rrugor me njohuritë e nevojshme për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore, duke parandaluar dhe zvogëluar pasojat në rast aksidenti rrugor.

Neni 2

Personi i interesuar për pajisje për herë të parë me leje drejtimi të mjetit rrugor duhet të regjistrohet pranë Kryqit të Kuq Shqiptar, degëve përkatëse, gjatë periudhës së kryerjes së programit teorik në autoshkolla.

Neni 3

1. Kryqi i Kuq Shqiptar kryen kursin e trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor sipas programit mësimor teorik dhe praktik të miratuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Ministria e Shëndetësisë, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Programi i kursit të trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor përgatitet dhe përditësohet në përputhje me normat dhe standardet europiane dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë rrugore. Ky program është pjesë integrale e strategjisë kombëtare të sigurisë rrugore 2011-2020 dhe planit të veprimit për sigurinë rrugore 2011-2015, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 23.2.2011 “Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore”.

2. Tarifa për çdo person që kryen kursin e trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor është 1500 (një mijë e pesëqind) lekë duke përfshirë dhe TVSH-në.

3% e kësaj tarife derdhet në buxhetin e MPPT-së nga Kryqi i Kuq Shqiptar çdo 6 muaj dhe përdoret për përmirësimin e sigurisë rrugore.

3. Kryqi i Kuq Shqiptar pajis me dëshmi në përfundim të kursit të trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor çdo person, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kryqi i Kuq Shqiptar plotëson regjistrin e Kursit të Trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor në mënyrë elektronike sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe ia dërgon atë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.



Neni 4

1. Personi i interesuar për të hyrë në prova për leje drejtimi të mjetit rrugor, në zbatim të nenit 119 të Kodit Rrugor, paraqet nëpërmjet drejtuesit teknik të autoshkollës, në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, dëshminë e kursit të trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor, së bashku me dokumentet e përcaktuara për marrjen në provën e njohurive teorike.

2. Sektori përkatës i DRSHTRR-së, pasi verifikon dëshminë e kursit të trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor, plotëson dokumentet e personit të interesuar për të hyrë në prova për lejedrejtimi të mjetit rrugor me fotokopjen e nënshkruar nga punonjësi i pranimit.

3. Komisioni i kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi të mjetit rrugor, realizon provën e testimit vetëm për personat e interesuar të cilët në dokumentet e paraqitura është e fotokopja e nënshkruar e dëshmisë së kursit të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar.

Neni 5

1. Dëshmia e kursit të trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor është e vlefshme për drejtuesit e mjeteve rrugore që kërkojnë të marrin kategori më të lartë lejedrejtimi dhe plotësimi i dokumentacionit bëhet si në nenin 4 pika 2.

2. Personi i interesuar për të hyrë në prova për lejedrejtimi të mjetit rrugor, i cili ka kryer studimet e larta në degët mjekësi apo infermieri, nuk e kryen kursin e trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor.

Personi i interesuar për të hyrë në prova për leje drejtimi, dorëzon fotokopjen e diplomës të nënshkruar nga urdhrat përkatës (urdhri i mjekut dhe urdhri i infermierit), dhe administrohet nga punonjësi përkatës i sektorit të DPSHTRR-së.

Neni 6

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Kryqi i Kuq Shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ndërsa për monitorimin e tij Sekretaria Teknike e Komitetit Ndërmintor të Sigurisë Rrugore dhe Drejtoria e Planifikimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë.

Neni 7

Udhëzimi nr. 1968, datë 28.4.2005 “Për organizimin e kursit të ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti”, udhëzimi nr. 3846, datë 29.8.2005 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1968, datë 28.4.2005 “Për organizimin e kursit të ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti” dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me këtë udhëzim shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.


**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Oldashi**

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
Petrit Vasili**

KRYQI I KUQ SHQIPTAR

Kryqi i Kuq Shqiptar ka 39 degë lokale sipas paraqitjes së mëposhtme:

1	Dega e Kryqit të Kuq Malësi e Madhe
2	Dega e Kryqit të Kuq Tropojë
3	Dega e Kryqit të Kuq Has
4	Dega e Kryqit të Kuq Kukës
5	Dega e Kryqit të Kuq Dibër
6	Dega e Kryqit të Kuq Bulqizë
7	Dega e Kryqit të Kuq Shkodër
8	Dega e Kryqit të Kuq Pukë
9	Dega e Kryqit të Kuq Mirditë
10	Dega e Kryqit të Kuq Mat
11	Dega e Kryqit të Kuq Lezhë
12	Dega e Kryqit të Kuq Kurbin
13	Dega e Kryqit të Kuq Krujë
14	Dega e Kryqit të Kuq Durrës
15	Dega e Kryqit të Kuq Shijak
16	Dega e Kryqit të Kuq Tiranë
17	Dega e Kryqit të Kuq Kamëz
18	Dega e Kryqit të Kuq Kavajë
19	Dega e Kryqit të Kuq Elbasan
20	Dega e Kryqit të Kuq Librazhd
21	Dega e Kryqit të Kuq Peqin
22	Dega e Kryqit të Kuq Gramsh
23	Dega e Kryqit të Kuq Lushnjë
24	Dega e Kryqit të Kuq Fier
25	Dega e Kryqit të Kuq Berat
26	Dega e Kryqit të Kuq Kuçovë
27	Dega e Kryqit të Kuq Patos
28	Dega e Kryqit të Kuq Mallakastër
29	Dega e Kryqit të Kuq Skrapar
30	Dega e Kryqit të Kuq Vlorë
31	Dega e Kryqit të Kuq Gjirokastrë
32	Dega e Kryqit të Kuq Pogradec
33	Dega e Kryqit të Kuq Përmet
34	Dega e Kryqit të Kuq Tepelenë
35	Dega e Kryqit të Kuq Korçë
36	Dega e Kryqit të Kuq Devoll
37	Dega e Kryqit të Kuq Kolonjë
38	Dega e Kryqit të Kuq Delvinë
39	Dega e Kryqit të Kuq Sarandë





PROGRAMI MËSIMOR TEORIK DHE PRAKTIK DHE ORËT PËR ZHVILLIMIN E KURSIT
TË TRAJNIMIT PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË SHPEJTË MJEKËSORE NË RAST
AKSIDENTI RRUGOR I CILI KRYHET NGA KRYQI I KUQ SHQIPTAR

1. Programet e trajnimit do të kenë këtë përmbajtje:

- Teori. Njohuri për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor. Materiale të vendeve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, që kanë eksperiencë në fushën e dhënies së ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor.



- Praktika. Shembuj ushtrimor dhe pjesë projektsh tipike të rrugëve (segmente autostrade, rrugë interurbane, rrugë urbane, rrugë lokale, kryqëzime etj.) që kanë të bëjnë me dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor.

2. Kalendar i zhvillimit të programit

FAZAT	EMËRTIMI	KOHA
Dita e parë	Pjesa teorike Pjesa praktike Gjithsej	T-80 minuta P-160 minuta 240 minuta
Mësimi 1	-Hyrje. Qëllimi dhe objektivat e kursit të trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor. Përgjegjësitë e dhënësit të ndihmës së shpejtë. Detyrat për të dhënë ndihmën e shpejtë. Zinxhiri i masave të shpëtimit.	T-30 minuta
Mësimi 2	-Zona e rrezikut. Siguria në vendin e ngjarjes. Metodat e lëvizjes të të lënduarit. Kaska mbrojtëse dhe heqja e saj.	T-20 minuta P-50 minuta
Mësimi 3	-Kontrolli i të lënduarit që nuk ka vetëdije, nuk ka frymëmarrje, nuk i punon zemra. Frymëmarrja artificiale. Masazhi i zemrës për të rriturit, për fëmijët dhe foshnjat.	T-30 minuta P-50 minuta
Mësimi 4	-Pengesat gjatë frymëmarrjes. Mbytja te të rriturit dhe te foshnjat.	T-20 minuta P-40 minuta
Dita e dytë	Pjesa teorike Pjesa praktike Gjithsej	T-90 minuta P-150 minuta 240 minuta
Mësimi 5	-Lëndimet dhe llojet e plagëve	T-20 minuta P-40 minuta
Mësimi 6	-Lëndimet nga nxehtësia. Djegiet, llojet e djegieve. Mërdhirjet. Shoku, shkaktarët dhe shenjat e shokut.	T-15 minuta P-15 minuta
Mësimi 7	-Lëndimet muskuloskelatore. Llojet e lëndimeve. Fashimi, llojet e fashimit, Imobilizimi fillestar i gjymtyrëve. Sëmundjet e ndryshme. Helmimet.	T-60 minuta P-30 minuta
Mësimi 8	-Vlerësimi teorik dhe praktik për kursantin. -Mbyllja e kursit dhe pajisja me dëshmi	T-20 minuta P-40 minuta

Modeli Dëshmisë së Kursit të ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar

Përmasat e Dëshmisë janë 6 x 8.5 cm

	
DËSHMI	
Emri _____ Atësia _____ Mbiemri _____	
Përfundoi Kursin e Ndihmës së Shpejtë Mjekësore në rast aksidenti nga Kryqi i Kuq Shqiptar	
Datëlindja _____	Vëndbanimi _____
Data e lëshimit _____	Nr. Regjistrimit _____
Grupi i gjakut _____	
Kryetari i Kryqit Kuq Dega _____	
Emri _____	Mbiemri _____
Nr. Serisë 00000001	



KRYQI I KUQ SHQIPTAR

Nr. Prot.

....., datë...../...../201..

Programi i Ndhmës së Parë

Dega _____

LISTA E PJESËMARRËSVE

QË U TRAJNUAN PËR NDIHMËN E SHPEJTË.

Koha e zhvillimit të kursit të trajnimit: datë ___/___/___, deri më datë ___/___/___.

Nr. rend.	Emri, atësia dhe mbiemri	Datëlindja e plotë	Numri i regjistrit të Amzës	Numri i serisë së Dëshmisë.
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				

SEKRETARI I DEGËS _____

UDHËZIM
Nr. 6, datë 6.4.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 41, DATË 8.12.2009 “PËR PROCEDURAT
DHE KRITERET E NJOHJES SË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE TË LËSHUARA
NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 37 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Titulli i udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat dhe kriteret e njohjes së diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për procedurën e njohjes zyrtare dhe njehsimit të diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”.

II. Shkronjat “c” dhe “d” të pikës 1 të udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 revokohen.

III. Pika 2.2 e udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 ndryshon si më poshtë vijon:

“Dokumentet e përcaktuara në pikën 2.1 të këtij udhëzimi duhet të jenë dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentet e shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 2.1, për shtetasit e huaj, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar, si edhe të noterizuara.

Dokumentet e shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2.1, duhet të jenë të pajisura me vulën *Apostille*. Në rastet kur kjo vulë mungon, ndiqet procedura e përcaktuar në pikën 3.2 të këtij udhëzimi.”.

IV. Pika 3.4 e udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 ndryshohet si më poshtë:

“3.4 Komisioni i njohjes pezullon procedurën e njohjes për raste të veçanta kur ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumenteve shkollore ose kryerjen e programit të studimit të pretenduar dhe përcakton afatet dhe masat për mbylljen e procedurës.”.

V. Në pikën 4.3 të udhëzimit shtohet kjo fjali: “SENJOD në bazë të vendimit të komisionit të njohjes përgatit vërtetimin e njohjes dhe njehsimit, për çdo aplikim.”.

VI. Pika 4.4 e udhëzimit ndryshohet si më poshtë:

“4.4 Në përfundim të procedurës, aplikantit i lëshohet një vërtetim njohjeje dhe njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës. Vërtetimi nënshkruhet nga kryetari i Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Format i vërtetimit të njohjes dhe njehsimit, bashkëlidhur shtojca nr. 1, përmban këto elemente:

a) emri, atësia dhe mbiemri i kandidatit;

b) institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;

c) shtetin përkatës;

d) kohëzgjatjen e programeve të studimit;

e) titullin e diplomës;

f) emërtimin e programit të studimeve të kryera shoqëruar me kreditet e përfituata sipas sistemit ECTS (European Credit Transfer System-Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve), në ato raste kur është e mundur të përcaktohet në bazë të të dhënave të suplementit të diplomës ose listës së notave.

g) njehsimin e diplomës përkatëse sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.



VII. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, si dhe Komisioni i Njohjes së Diplomave.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

SHTOJCA NR.1
FORMATI I VËRTETIMIT TË NJOHJES DHE NJEHSIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. i regjistrimit.....

Tiranë, më.../.../...

VËRTETIM NJOHJEJE DHE NJEHSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës së z/znj (emër, atësia, mbiemër), lëshuar nga
(institucioni i huaj i arsimit të lartë),.....(shteti), me program vjeçar (kohëzgjatja e programit), (titulli i diplomës së lëshuar) në(emërtimi i programit të studimit) me ECTS (numri i krediteve të përfituara)

Kjo diplomë nejhsohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

KRYETAR I KOMISIONIT

(emër, mbiemër)

(emër, mbiemër)

(firma, vula e institucionit)

Shënim. Ky vërtetim njohjeje është i vlefshëm kur shoqërohet me diplomën e huaj.

UDHËZIM
Nr. 7, datë 19.3.2012

**PËR PËRDORIMIN E ADITIVIT USHQIMOR “E 960 STEVIOL GLYCOSIDE” NË
PRODUKTET USHQIMORE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përdorimi i aditivit ushqimor “E 960 Steviol Glykoside” në produktet ushqimore të prodhuara ose të importuara në Republikën e Shqipërisë, të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
Genc Ruli



SHTOJCA I
KRITERET E PËRDORIMIT TË ADITIVIT USHQIMOR “E 960 STEVIOL GLYKOSIDES” SIPAS KATEGORIVE TË USHQIMEVE

Numri i kategorisë	E numër	Emri	Niveli maksimal (mg/l ose mg/kg)	Shënim plotësues (footnote)	Kufizime/përjashtime
01.4	Produktet e fermentuara të aromatizuara të qumështit, duke përfshirë produktet e trajtuara në temperaturë të lartë				
	E 960	Steviol glycosides	100	(60)	vetëm produkte me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
03	Akull ushqimor				
	E 960	Steviol glycosides	200	(60)	vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
04.2.2	Fruta dhe perime në uthull, vaj ose shëllirë				
	E 960	Steviol glycosides	100	(60)	vetëm konservim i ëmbël-i thartë i frutave dhe perimeve
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
04.2.4.1	Fruta dhe perime të përgatitura me përjashtim të kompostove				
	E 960	Steviol glycosides	200	(60)	vetëm me energji të reduktuar
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
04.2.5.1	Reçel i veçantë dhe xhel i veçantë				
	E 960	Steviol glycosides	200	(60)	vetëm reçel, xhele dhe marmalada me energji të reduktuar
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
04.2.5.2	Reçel, xhel, marmaladë dhe pure gështenje e ëmbëlsuar				
	E 960	Steviol glycosides	200	(60)	vetëm reçel, xhele dhe marmalada me energji të reduktuar
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
04.2.5.3	Fruta ose perime të tjera të ngjashme				
	E 960	Steviol glycosides	200	(60)	vetëm fruta të thata të vendosura në formë shumë shtresash, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			

05.1	Kakao dhe produktet e çokollatës				
	E 960	Steviol glycosides	270	(60)	vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
(60):të shprehur si ekuivalente të steviol					
05.2	Ëmbëlsira të tjera, përfshirë ëmbëlsirat e vogla për freskimin e frymëmarrjes				
	E 960	Steviol glycosides	270	(60)	vetëm me bazë kakao ose fruta të thata, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	E 960	Steviol glycosides	330	(60)	vetëm kakao, qumësht, fruta të thata ose sanduiç me bazë yndyrë, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	E 960	Steviol glycosides	350	(60)	vetëm ëmbëlsira pa sheqer të shtuar
	E 960	Steviol glycosides	2000	(60)	vetëm mikroëmbëlsirat për freskim të frymëmarrjes, pa sheqer të shtuar
	E 960	Steviol glycosides	670	(60)	vetëm tableta të aromatizuara fort për freskimin e fytit pa sheqer të shtuar
(60):të shprehur si ekuivalente të steviol					
05.3	Çamçakëz				
	E 960	Steviol glycosides	3300	(60)	vetëm pa sheqer të shtuar
(60):të shprehur si ekuivalente të steviol					
05.4	Zbukurimet, mbështjelljet dhe mbushjet, përveç mbushjeve me bazë frutash të mbuluara nga kategoria 4.2.4				
	E 960	Steviol glycosides	330	(60)	vetëm ëmbëlsira pa sheqer të shtuar
		Steviol glycosides	270	(60)	vetëm me bazë kakao ose fruta të thata, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
(60):të shprehur si ekuivalente të steviol					
06.3	Cereale për mëngjes				
	E 960	Steviol glycosides	330	(60)	vetëm drithëra për mëngjes, me një përmbajtje fibrash jo më shumë se 15%, dhe që përmbajnë të paktën 20% krunde, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
(60):të shprehur si ekuivalente të steviol					
07.2	Produkte të pjekura shumë mirë				
	E 960	Steviol glycosides	330	(60)	vetëm “essoblaten” – meshë e hollë



		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
09.2	Peshk dhe produkte të peshkimit të përpunuara, duke përfshirë molusqet dhe krustacet				
	E 960	Steviol glycosides	200	(60)	vetëm peshq të konservuar dhe gjysmë të konservuar në të ëmbël-të thartë, peshq të marinuar, molusqe dhe krustace
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
11.4.1	Ëmbëlsues tavoline në formë të lëngshme				
	E 960	Steviol glycosides	SD(1)	(60)	
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
11.4.2	Ëmbëlsues tavoline në formë pluhuri				
	E 960	Steviol glycosides	SD(1)	(60)	
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
11.4.3	Ëmbëlsues tavoline në formë tabletash				
	E 960	Steviol glycosides	SD(1)	(60)	
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
12.5	Supë dhe lëng mishi				
	E 960	Steviol glycosides	40	(60)	vetëm supë me energji të reduktuar
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
12.6	Salca				
	E 960	Steviol glycosides	120	(60)	përveç salcës së sojës (të fermentuar dhe të pafermentuar)
		Steviol glycosides	175	(60)	vetëm salcë soje (të fermentuar dhe të pafermentuar)
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
13.2	Ushqime dietike për qëllime të veçanta mjekësore (me përjashtim të produkteve të kategorisë ushqimore 13.1.5)				
	E 960	Steviol glycosides	330	(60)	
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
13.3	Ushqime dietike për dietat e kontrollit të peshës të paracaktuara të zëvendësojnë plotësisht marrjen e ushqimit ditor ose një vakt individual (plotësisht apo pjesërisht dietën e plotë ditore)				
	E 960	Steviol glycosides	270	(60)	
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			

14.1.3	Nektar frutash e perimesh dhe produkte të ngjashme				
	E 960	Steviol glycosides	100	(60)	vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
14.1.4	Pije të aromatizuara				
	E 960	Steviol glycosides	80	(60)	vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
14.2.1	Birrë dhe pije malti				
	E 960	Steviol glycosides	70	(60)	vetëm birrë pa alkool ose me përmbajtje alkooli që nuk i kalon 1.2% vol.; “Bière de table/Tafelbier/Table beer” (përmban më pak se 6%) me përjashtim të “Oberjähriges Einfachbier”; birra me aciditet minimal 30 mili-ekuivalent e shprehur si NaOH; birrë kafe e tipit “oud bruin”
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
14.2.8	Pije të tjera alkoolike duke përfshirë edhe alkoolet e me më pak se 15% alkool dhe përzierjet e pijeve alkoolike me joalkoolike				
	E 960	Steviol glycosides	150	(60)	
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
15.1	Snack me bazë patate, drithëra, miell apo niseshte				
	E 960	Steviol glycosides	20	(60)	
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
15.2	Arra të përpunuara				
	E 960	Steviol glycosides	20	(60)	
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
16	Ëmbëlsira duke përjashtuar produktet e mbuluara në kategorinë 1, 3 dhe 4				
	E 960	Steviol glycosides	100	(60)	vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
17.1	Ushqimet shtesë të furnizuar në formë të ngurtë duke përfshirë kapsulat, tabletat dhe format e ngjashme				
	E 960	Steviol glycosides	670	(60)	
	(60):të shprehur si ekuivalente të steviol				
17.2	Ushqimet shtesë të furnizuar në formë të lëngshme				



	E 960	Steviol glycosides	200	(60)	
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			
17.3	Ushqimet shtesë të furnizuar si tip shurupi ose në formë përtypëse				
	E 960	Steviol glycosides	1800	(60)	
		(60):të shprehur si ekuivalente të steviol			

⁽¹⁾ Sasi e dëshirueshme

VENDIM
Nr. 16, datë 13.3.2012

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KREDINË PËR MBËSHTETJE
ME LIKUIDITET”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 16 paragrafi 1 dhe nenit 43 shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për kredinë për mbështetje me likuiditet”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit European dhe Komunikimit për botimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
 4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja “Për kredinë Lombard”, miratuar me vendimin nr. 57, datë 13.7.2005 të Këshillit Mbikëqyrës, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR KREDINË PËR MBËSHTETJE ME LIKUIDITET

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve për dhënien e kredisë për mbështetje me likuiditet për një bankë që ka mungesë të përkohshme likuiditeti, por që është financiarisht e qëndrueshme.

Neni 2
Përkufizime

- Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
- a) “Kredia për mbështetje me likuiditet” është instrument mbështetës që Banka e Shqipërisë mund të përdorë për plotësimin e nevojave afatshkurtra për likuiditet të bankave.
 - b) “Bankë” është personi juridik sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
 - c) “Dorëzim kundrejt pagesës” është një procedurë e tregtimit të titujve, në të cilën pagesa e blerësit për titullin bëhet në kohën e dorëzimit të titullit. Pagesa e *cash*-it dhe dorëzimi i titullit është i njëkohshëm.
 - d) “Kredi” është “kredia për mbështetje me likuiditet”.



- e) “Akordim” është marrja e vendimit për dhënien e kredisë.
- f) “Lëvrimit” është disbursimi i kredisë në llogari të bankës.
- g) “Norma e tregut” është norma Euribor ose Libor me maturim 3-mujor në ditën e lëvrimit të kredisë. Interesi është i shprehur me dy shifra pas presjes dhjetore dhe llogaritet me 360 ditë.
- h) “Kosto mesatare e fondeve” është interesi mesatar i depozitave të reja me afat maturimi 3- mujor të sistemit sipas publikimit më të fundit të Bankës së Shqipërisë në ditën e livrimit të kredisë. Interesi është i shprehur me dy shifra pas presjes dhjetore dhe llogaritet me 360 ditë.

Neni 3

Dokumentacioni i nevojshëm për kredisë

Aplikimi/kërkesa e kredisë shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) raport mbi gjendjen e likuiditetit dhe shkaqet e mungesës së likuiditetit;
- b) listë të detajuar të veprimeve të ndërmarra për të siguruar likuiditet nga të gjitha burimet e mundshme;
- c) listë të garancive të zotëruara që do të paraqesë në Bankën e Shqipërisë për sigurimin e kredisë;
- d) planveprimi për daljen nga situata e mungesës së likuiditetit;
- e) plan të përdorimit të shumës së kredisë gjatë kohëzgjatjes së saj; dhe
- f) çdo dokument tjetër që mund të kërkohet nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Neni 4

Forma e kredisë

Kredia mund të jetë e formës hua e kolateralizuar ose marrëveshje riblerjeje.

Neni 5

Instrumentet për garantimin e kredisë

Kredia për mbështetje me likuiditet është kredi plotësisht e garantuar, ku si mjete për garantimin e saj përdoren instrumentet e mëposhtme:

- a) titujt në lekë dhe/ose në valutë të emtuar ose të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe Banka e Shqipërisë, si dhe titujt në lekë të emtuar nga organet e pushtetit vendor në Republikën e Shqipërisë të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
- b) titujt të denominuar në valutë të huaj, të cilët janë të lejueshëm për investimin e rezervës valutore sipas përcaktimeve në rregulloren “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”;
- c) rezerva e detyrueshme në lekë dhe në valutë deri 80% të nivelit të saj në llogarinë e bankës me Bankën e Shqipërisë, në ditën e akordimit të kredisë; dhe/ose
- d) mjete të tjera, në rastet e nenit 6, paragrafi 4.

Neni 6

Vlerësimi i instrumenteve garantuese të kredisë

1. Masat e vlerësimit të rrezikut për instrumentet e listuara në nenin 5 shkronjat “a” dhe “b” përcaktohen në aneksin bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Garancia e vendosur sipas nenit 5 shkronja “c” mban vlerën fillestare gjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë, dhe nuk ndikohet nga ecuria e rezervës së detyrueshme të bankës gjatë kësaj kohe.

3. Në rast se gjatë periudhës që kredia është livruar, vlera e garancive bie nën nivelin e lejuar sipas përcaktimit në aneksin bashkëlidhur, atëherë brenda 3 (tre) ditëve pune nga njoftimi i Bankës së Shqipërisë, banka është e detyruar të plotësojë vlerën e garancisë duke:

a) depozituar *cash*; dhe/ose

b) transferuar vlerë të mjaftueshme të garancive, të pranuar sipas nenit 5.

4. Në rast të mungesës së garancive sipas paragrafit 3, banka transferon vlerë të mjaftueshme të aktiveve të tjera që disponon dhe që mund të pranohen nga Banka e Shqipërisë si garanci, me vendim të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës. Banka transferon garancitë e tjera brenda 3 (tre) ditëve pune nga komunikimi i vendimit të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 7

Shuma e kredisë

1. Banka paraqet kërkesën e kredisë deri në shumën e lejuar nga garancitë që do të vendosë për garantimin e kësaj kredie.

2. Në çdo rast, shuma e kredisë që do të akordohet përcaktohet nga Banka e Shqipërisë pas vlerësimit të instrumenteve garantuese, në përputhje me masat e kontrollit të rrezikut.

Neni 8

Kohëzgjatja e kredisë

1. Kredia për mbështetje me likuiditet ka afat jo më të gjatë se 92 (nëntëdhjetë e dy) ditë nga dita e lëvrimit të saj.

2. Banka ka të drejtë të kërkojë/aplikojë për kredi tjetër në përputhje me kushtet e kësaj rregulloreje.

Neni 9

Interesi i kredisë

Interesi i kredisë për mbështetje me likuiditet është:

a) për kredinë në lekë, 4 (katër) për qind më i lartë se norma bazë e Bankës së Shqipërisë;

b) për kredinë në euro ose dollarë amerikanë, 4 (katër) % më i lartë se maksimumi i normës së tregut dhe koston mesatare të fondeve në monedhën përkatëse.

Neni 10

Struktura vendimmarrëse

Akordimi dhe forma e kredisë vendoset nga Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë, bazuar në:

a) propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, i cili shoqërohet me analizë dhe vlerësim të situatës financiare të bankës, si dhe të dokumentacionit të paraqitur nga banka sipas nenit 3, paragrafit 2 të kësaj rregulloreje;

b) opinionin e Komitetit të Stabilitetit Financiar mbi përshtatshmërinë e akordimit të kredisë; dhe

c) opinionin e Departamentit të Operacioneve Monetare mbi vlefshmërinë dhe vlerën e instrumenteve garantuese.



Neni 11

Livrimi dhe shlyerja e kredisë

1. Departamenti i Operacioneve Monetare njofton menjëherë bankën për miratimin e kredisë dhe lidh marrëveshjen për akordimin e saj, duke përdorur një nga mjetet e komunikimit: *Reuters*, *Swift* ose shkresë zyrtare.

2. Për rastet kur kredia është e garantuar vetëm nga instrumentet e përcaktuara në nenin 5, shkronjat “a” dhe “c”, livrimi i kredisë bëhet në përputhje me parimin “dorëzim kundrejt pagesës”.

3. Për rastet kur kredia është e garantuar përveç të tjerave edhe me instrumente sipas nenit 5, shkronja “b”, lëvrimi i kredisë bëhet kur konfirmohet transferimi i garancive në llogarinë e titujve të Bankës së Shqipërisë.

4. Në ditën e maturimit të kredisë, banka i kthen Bankës së Shqipërisë shumën e kredisë bashkë me interesin, dhe Banka e Shqipërisë liron garancitë e vendosura në përputhje me parimin “dorëzim kundrejt pagesës”.

5. Banka mund të kthejë kredinë përpara ditës së maturimit, duke paguar interesin përkatës vetëm për periudhën për të cilën e ka shfrytëzuar këtë kredi.

Neni 12

Dispozitë e fundit

1. Banka e Shqipërisë fillon procedurat përkatëse për ekzekutimin e garancive në rastet e:

a) moskthimit të kredisë brenda afatit;

b) mospagesës së interesit;

c) mosplotësimit të vlerës së garancisë sipas paragrafëve 3 dhe 4, të nenit 6.

2. Në rast se vlera e përfituar nga ekzekutimi i garancive është nën vlerën e kredisë bashkë me interesin, Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë bankës diferencën përkatëse.

3. Gjatë kohëzgjatjes së kredisë për mbështetje me likuiditet, pa miratimin paraprak të Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare, banka nuk lejohet të japë garanci për palë të treta.

ANEKS

Masat e kontrollit të rrezikut do të zbatohen vetëm për titujt e vendosur si garanci për kredinë për mbështetje me likuiditet. Vlerësimi i titujve bëhet të paktën një herë në javë.

Ato përbëhen nga:

a) marzhi fillestar (*initial margin*);

b) marzhi reduktues (*haircut*); dhe

c) marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut (*margin call*).

a) Marzhi fillestar. Banka e Shqipërisë kërkon që garancia e vendosur nga banka të jetë e barabartë me shumën e kredisë së akorduar, plus një përqindje të caktuar. Kjo përqindje e caktuar është marzhi fillestar. Marzhi fillestar për kredinë për mbështetje me likuiditet do të jetë 10%.

b) Marzhi reduktues i referohet përqindjes së caktuar që i zbritet vlerës së tregut të titullit. Kjo përqindje reflekton karakteristikat e letrës me vlerë, të tillë si maturimi i mbetur, rreziku i kreditit të emetuesit, monedha dominuese, likuiditeti etj.

1. Marzhet reduktuese për titujt e emetuar ose të garantuar nga qeveria qendrore dhe qeveritë vendore në Republikën e Shqipërisë.

TABELA NR. 1
TITUJT E EMETUAR NGA QEVERIA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT
VENDOR, TË NDARË SIPAS KATEGORISË SË LIKUIDITETIT/MONEDHËS

Kategoria I	Kategoria II	Kategoria III
Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga Qeveria e RSH në lekë	Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga Qeveria e RSH në valutë	Titujt në lekë të emetuar nga organet e pushtetit vendor në Republikën e Shqipërisë të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë

TABELA NR. 2
MARZHI REDUKTUES SIPAS KATEGORIVE TË LIKUIDITETIT TË TITUJVE TË EMETUAR
NGA QEVERIA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT VENDOR

Maturimi i mbetur në vite	Titujt sipas kategorive					
	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Kupon fiks	Zero kupon	Kupon fiks	Zero kupon	Kupon fiks	Zero kupon
0-1	6.0	6.0	20.0	20.0	10.0	10.0
1-3	8.0	8.0	30.0	35.0	15.0	15.0
3-5	9.0	10.0	40.0	45.0	20.0	22.0
5-7	11.0	12.0	50.0	55.0	25.0	27.0
7-10	13.0	14.0	60.0	65.0	28.0	30.0
> 10	15.0	18.0	70.0	75.0	33.0	35.0

Titujt me kupon të ndryshueshëm kanë të njëjtin marzh reduktues si grupi i titujve me kupon fiks me maturim të mbetur nga 0 (zero) deri 1 (një) vit.

Zero kupon përfshijnë titujt me kupon zero dhe titujt e shitur me skonto (bonot e thesarit).

Kur titujt e emetuar nga qeveria qendrore ose organet e pushtetit vendor të vendosur si garanci përbëjnë në total më shumë se 10% të borxhit publik të emetuar nga qeveria qendrore ose pushteti vendor, shtohet një marzh reduktues prej 15%.

2. Marzhet reduktuese për tituj të denominuar në valutë të huaj, të cilët janë të lejueshëm për investimin e rezervës valutore sipas përcaktimeve në rregulloren “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”

TABELA NR. 3
TITUJT TË NDARË SIPAS KATEGORISË SË LIKUIDITETIT/MONEDHËS

Kategoria I	Kategoria II	Kategoria III
Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga qeveritë qendrore	Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga agjenci qeveritare ose autoritet tjetër i një qeverie sovrane	Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga banka



Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga bankat qendrore	Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga institucione shumëpalëshe	Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga institucione financiare
	Tituj të emetuar ose të garantuar në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar nga organe publike (organet e pushtetit vendor ose autoritet tjetër që i shërben qeverisë)	

TABELA NR. 4
MARZHI REDUKTUES SIPAS KATEGORIVE TË LIKUIDITETIT

Vlerësimi i rrezikut të kreditit	Maturimi i mbetur në vite	Titujt sipas kategorive					
		Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
		Kupon fiks	Zero kupon	Kupon Fiks	Zero kupon	Kupon fiks	Zero kupon
Nga AAA deri në A-	0-1	0.5	0.5	1.0	1.0	6.5	6.5
	1-3	1.5	1.5	2.5	2.5	8.5	9.0
	3-5	2.5	3.0	3.5	4.0	11.0	11.5
	5-7	3.0	3.5	4.5	5.0	12.5	13.5
	7-10	4.0	4.5	5.5	6.5	14.0	15.5
	> 10	5.5	8.5	7.5	12.0	17.0	22.5
Nga BBB+ deri në BBB-	0-1	5.5	5.5	6.0	6.0	15.0	15.0
	1-3	6.5	6.5	10.5	11.5	27.5	29.5
	3-5	7.5	8.0	15.5	17.0	36.5	39.5
	5-7	8.0	8.5	18.0	20.5	38.5	43.0
	7-10	9.0	9.5	19.5	22.5	39.0	44.5
	> 10	10.5	13.5	20.0	29.0	39.5	46.0

Titujt me kupon të ndryshueshëm kanë të njëjtin marzh reduktues si grupi i titujve me kupon fiks, me maturim të mbetur nga zero deri 1 vit.

Kur titulli është me kupon të zhdrejtë (inverse floater), marzheve reduktuese të paraqitura në tabelën 4 u shtohet marzhi reduktues prej 10% për grupet zero deri në 5 vjet, prej 15% për grupin 5 deri në 10 vjet dhe 20% për grupin mbi 10 vjet.

c) Marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut. Banka e Shqipërisë kërkon që vlera e tregut e garancisë së axhustuar me marzhin reduktues, të ruhet gjatë kohëzgjatjes së kredisë për mbështetje me likuiditet të akorduar prej saj. Kjo nënkupton që në rast se, kjo vlerë e matur në intervalet e përcaktuara të vlerësimit brenda kohëzgjatjes së kredisë, bie nën një “nivel të caktuar”, Banka e Shqipërisë i kërkon bankës të depozitohë aktive të tjera sipas përcaktimit në rregullore deri në plotësimin e vlerës së garancisë. Marzhi i ruajtjes së tregut përdoret për llogaritjen e “nivelit të caktuar”. Marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut aplikohet në mënyrë simetrike që do të thotë që, në rast se vlera e tregut rritet mbi nivelin e caktuar, atëherë banka ka të drejtë t’i kërkojë Bankës së Shqipërisë pjesën e tepërt të titullit të vendosur si garanci.

Marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut do të jetë 2% e vlerës së kredisë.

VENDIM
Nr. 23, datë 24.2.2012

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT TË ENERJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.2.2012, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për disa ndryshime në rregullat e tregut të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në rregullat e tregut të energjisë elektrike (Ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

NDRYSHIMET NË RREGULLAT E TREGUT TË ENERJISË ELEKTRIKE

A. Në kapitullin VII.2 “Pjesëmarrësit në tregun e balancimit”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

A.1 Pika VII. 2. i, bëhet si më poshtë:

VII. 2. 1 Të gjithë pjesëmarrësit në treg me programe të regjistruara

A.2 Pika VII. 2. ii, shfuqizohet.

A.3 Pika VII. 2. 2 paragrafi “iii”, në fund të fjalisë shtohen fjalët “ose grup konsumatorësh”.

B. Në kapitullin VII.3 “Kërkesat dhe ofertat; parashtrimi i kërkesave dhe ofertave”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

B.1- Pika VII .3.1 ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

VII.3.1 OST duhet të nxjerrë parashikimet e përditësuara brenda orës 10:00 përpara ditës së dispecerimit në kohë reale, që udhëzon tregun e energjisë lidhur me disbalancat e pritshme. Jo më vonë se 10 ditë para fillimit të një muaji të caktuar gjatë vitit në avancë, OST-ja do të hartojë një plan mujor operimi për operimin e sistemit energjetik shqiptar bazuar në informacionin mujor të përditësuar, të siguruar nga pjesëmarrësit e tregut.

B.2 – Pika VII.3.2 paragrafi i parë shfuqizohet.

B.3 - Në pikën VII.3.2 paragrafi “vii” germa “a”, fjala “energjisë” zëvendësohet me fjalën “kapacitetit”.

B.4 – Pikat VII.3.4, VII.3.6, VII.3.7, VII.3.8, VII.3.9, VII.3.10, VII.3.12, VII.3.13, VII.4, VII.5, VII.6, shfuqizohen.



C. Në kapitullin IX “Rregullat për llogaritjen e disbalancave”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

C.1 – Pika IX.1.3 ndryshon dhe bëhet:

IX.1.3 a) Çmimi i energjisë balancuese llogaritet për çdo muaj si mesatare e ponderuar e çmimeve të të gjitha blerjeve që ka bërë KESH sh.a. gjatë muajit, plus 10% për inbalancat pozitive dhe çmimin e furnizuesit publik me shumicë për disbalancat negative, dhe në rastet e kryerjes së shkarkimeve nga KESH sh.a. për shkak të prurjeve të mëdha, ky çmim do të jetë 0 (zero).

b) Në rastet kur KESH sh.a. nuk do të bëjë importe të energjisë elektrike gjatë muajit n, për llogaritjen e çmimit të inbalancave pozitive, aplikohet çmimi mesatar i ponderuar i blerjeve të bëra nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes plus 10% gjatë muajit n, ndërsa për ato negative, ai i furnizuesit publik me shumicë.

c) OST sh.a. do të bëjë shumën algjebrike të disbalancave (pozitive dhe negative) mujore dhe do t’u dërgojë pjesëmarrësve të tregut faturat përkatëse.

d) “CEZ shpërndarje” sh.a. në funksionet e tij si Operator i Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit publik me pakicë do të jetë subjekt i inbalancave sipas dispozitave të mësipërme vetëm për inbalancat pozitive.

e) Kjo dispozitë të jetë deri në 6-mujorin e parë të vitit 2012.

f) Brenda datës 5 të muajit n+1, KESH sh.a. i dërgon OST sh.a. (Operatori i Tregut) çmimin mesatar (të ponderuar) të importeve të energjisë elektrike për muajin n. OST sh.a. brenda datës 10 të muajit n+1 u dërgon faturat pjesëmarrësve të tregut. Në llogaritjen e pagesave OST sh.a. do të përdorë kursin mesatar të këmbimit të euro/lekë të muajit n të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

l) Afatet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, nuk do të merren parasysh nga OST sh.a. për llogaritjen e inbalancave të pjesëmarrësve të tregut për muajin janar 2012. Disbalancat për muajin janar 2012 do të faturohen nga OST sh.a. brenda muajit shkurt 2012.

K. Disbalancat brenda kufirit +/- 5% do të kompensohen në natyrë në bazë në javën pas operimit.

C.2 – Pika IX.1.4 ndryshon dhe bëhet:

- IX.1.4 OST sh.a. publikon në faqen e saj zyrtare të internetit çmimin mesatar (të ponderuar) që është aplikuar për inbalancat.

OST sh.a. deri në datën 25 të muajit n+1 do të dërgojë në ERE një raport përmbledhës për inbalancat dhe çmimin e aplikuar për vlerësimin e këtyre inbalancave për muajin n.

C.3 – Pika IX.1.7 ndryshon dhe bëhet:

IX.1.7 OST i faturon çdo muaj çdo pjesëmarrësi tregu përgjegjës për disbalancat e shkaktuara vlerën të llogaritur sipas çmimit të miratuar nga ERE dhe disbalancave përkatëse të tyre.

C.4 – Pika IX.1.8 ndryshon dhe bëhet:

IX.1.8 OST e siguron energjinë balancuese të nevojshme për të mbuluar disbalancat e krijuara nga KESH – Gen.

C.5 - Pikat IX.1.5, IX.1.9 shfuqizohen.

C.6 – Pika IX.1.10 ndryshon dhe bëhet:

Llogaria e të ardhurave të balancimit të energjisë vjen nga shumëzimi i energjisë së balancimit me çmimin e balancimit të aplikueshëm për periudhën përkatëse.

D. Pika IX.2 shfuqizohet.

E. Në kapitullin X, bëhen ndryshimet si më poshtë:

E.1 Pikat X.1.2, X.1.3, X.1.4 shfuqizohen.

E.2. Në pikën X.1.10 në fjalinë e parë pas fjalës “mujore” vendoset fjala “ditore”.

E.2 Pika X.1.12 ndryshon dhe bëhet:

X.1.12 Në datën e ankandit vjetor, mujor ose ditor Operatori i Tregut i OST do të ndajë të gjitha kërkesat e pranuar në ankandin e interkoneksioneve në bazë të drejtimit të flukseve dhe në një rend zbritës të çmimit dhe do të shpallë fituesit e të drejtës për kapacitete në volumin e kërkuar për palën me çmimin marginal më të ulët.

F. Në kapitullin XI bëhen ndryshimet si më poshtë:

F.1 Pika XI.3.2 ndryshon dhe bëhet:

XI.3.2. Llogaritja e prodhimit – energjia e matur në llogarinë e gjeneruesit del nga mbledhja (nga çdo njësi balancuese e regjistruar në llogari) e diferencës mes leximeve orare të matësit në fund të periudhës së likuidimit me atë të marrë në periudhën fillestare. Për interkoneksione importuese, merret mbledhja e vlerave në fund të çdo ore të linjave të interkoneksioneve.

F.2. Pika XI.3.5 shfuqizohet.

G. Në kapitullin XII “Rregullat për faturimin dhe pagesën”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

G.1 Pika XII.1.2 ndryshon dhe bëhet:

- Faturat do të dorëzohen normalisht ditën e 10-të të muajit kalendarik pasardhës. Palët tregtare kanë 10 ditë për të paguar faturën.

G.2 Pikat XII.1.5 dhe XII.1.6 shfuqizohen.

G.3 Pika XII.2.3 ndryshon dhe bëhet:

XII.2.3 Operatori i Tregut OST-ja i dërgon deklaratën e realizimit të disbalancat për muajin në çdo pjesëmarrësi brenda 10 ditëve pas përfundimit të muajit përfshirë vlerën përkatëse që çdo pjesëmarrës tregu duhet të paguajë ose të marrë.

G.4 Pas pikës XII.2.3 shtohet pika XII.2.4:

XII.2.4

OST-ja i dërgon në të njëjtën ditë KESH Gen-it deklaratën e realizimit të disbalancave dhe faturën përkatëse e cila përmban vlerën që ky i fundit do të përfitojë për të gjithë energjinë balancuese të ofruar gjatë muajit N për rastet e inbalancave pozitive ose pagesën e vlerës në rastet e inbalancave negative të pjesëmarrësve të tregut.

G.5 Pika XII.3 ndryshon dhe bëhet:

XII.3 – Faturat për pagesat e inbalancave dhe përdorimit të sistemit të transmetimit

XII.3.1. OST-ja përgatit faturat për gjithë pjesëmarrësit për disbalancat dhe për përdorimin e rrjetit të sistemit të transmetimit.

G.6 Pika XII.3.2 shfuqizohet.

G.7 Pika XII.4.2 ndryshon dhe bëhet:

Pagesat e pakryera lidhur me çdo paqartësi ose mbi pagesë në faturë grumbullojnë një interes prej 0,5 % në ditë për çdo ditë vonese.

G.8 Pika XII.4.3 ndryshon dhe bëhet:

XII.4.3 Nëse rezultati i paqartësisë së faturës nuk është i drejtë ose OST-ja nuk ka vepruar në mënyrë të arsyeshme në menaxhimin e paqartësisë së faturës ose në llogaritjen e pagesës së debatueshme, atëherë OST detyrohet t'i paguajë pjesëmarrësit të tregut një interes prej 0,5 % në ditë të vlerës së diferencës së faturës së paguar prej tij për periudhën nga kryerja e pagesës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes.

G.9. Pika XII.4.4 ndryshon dhe bëhet:

Interesi është i pagueshëm në shumën që përfaqësojnë diferencën mes shumës së paguar dhe shumës korrekte pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe do t'i paguhet OST-së ose nga OST, sipas rastit.

G.10. Pika XII.4.5 ndryshon dhe bëhet:

Pas zgjidhjes së paqartësisë së faturës, pagesa duhet bërë brenda 3 (tre) ditëve pune nga zgjidhja e mosmarrëveshjes. Pas kësaj date, interesi mbi shumën e papaguar do të akumulohet interesi prej 0,5 % në ditë.



VENDIM
Nr. 30, datë 26.3.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL”
SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 14 pika 1 germa “a”, si dhe të rregullave dhe procedurave “Për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror” neni 4, pika 1 germa “a”; neni 8, neni 9 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2 germa “a” dhe nenin 10, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albpetrol sh.a.”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol sh.a.”, për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albpetrol sh.a.” në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 31, datë 26.3.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL”
SHA NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 14 pika 1 germa “b”, si dhe të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, neni 4, pika 1 germa “b”; neni 8, neni 9 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2 germa “b” dhe neni 10, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albpetrol sha”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol sh.a.”, plotëson pjesërisht kërkesat për licencimin në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror të kësaj shoqërie, të parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albpetrol sh.a.” në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 32, datë 26.3.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALBPETROL”
SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1 germa “a” dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht. (Mungon ekstrakti i QKR-së).

-Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore).

-Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10 pikat “a” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Ndërsa për pikën “b” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë informacion.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 33, datë 26.3.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALBPETROL”
SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, nenit 13 pika 1 germa “ç” dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pikat 1 germa “a” dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

-Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht (mungon ekstrakti i QKR-së).

-Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht. (Mungon neni 9, pika 3 germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore)).

-Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. Ndërsa për pikën “c” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Sokol Ramadani**

**VENDIM
Nr. 2, datë 18.1.2012**

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS KANALIZIME LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca e operatorit sh.a. ujësjellës kanalizime Librazhd me:
Drejtues ligjor: z. Petrit Arif Zeneli
Drejtues teknik: znj. Ermela Xhemal Xherri.
2. Operatori sh.a. UK Librazhd autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Librazhd, Përrenjas; komuna Qendër, Rrajcë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhe 4-vjeçare, deri më datë 18.1.2016.

**KRYETARI
Avni Dervishi**

**VENDIM
Nr. 4, datë 29.2.2012**

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË KONSUMATORËVE PËR DISA KLIENTË TË VEÇANTË

Në zbatim nenit 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.” dhe Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator



VENDOSI:

1. Të përcaktojë kategorinë e konsumatorëve sipas përkatësisë, për disa konsumatorë të veçantë, si më poshtë:

a) Trupat diplomatikë (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike) të trajtohen në kategorinë “ent publik”.

b) Komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit si kisha, xhami etj.) të trajtohen në kategorinë “ent publik”. Këtu bëjnë përjashtim ato institucione e struktura të krijuara nga këto komunitete të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore, shëndetësore e ekonomike, të cilat duhet të trajtohen në kategorinë “ent privat”.

c) Partitë politike (selitë dhe degët e tyre në qytete) të trajtohen si “Ent publik”;

d) Shoqëritë tregtare shtetërore (KESH sh.a., ndërmarrjet e trajtimit të studentëve, dhe çdo shoqëri tjetër shtetërore) të trajtohen si “ent privat”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr. 5, datë 29.2.2012

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA
“UK LIBRAZH D”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. “UK Librazhd”:

a) Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar	38 lekë/m ³	13 lekë/m ³
Institucione buxhetore	100 lekë/m ³	22 lekë/m ³
Ente private	100 lekë/m ³	23 lekë/m ³ .

2. Pagesa rregullatore për sh.a. “UK Librazhd” do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2012 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi

KËRKESE

Ismail Kapllani, lindur më 19.4.1941, banues në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Kapllan Kapllani.

KËRKUESI
Ismail Kapllani

KËRKESE

Shtetësja Qirjakulla Konomi, e datëlindjes 29.3.1955, lindur dhe banuese në Himarë, kërkon shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Kostë Konomi.

KËRKUESJA
Qirjakulla Konomi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.4.2012
Doli nga shtypi më 21.4.2012

Tirazhi: 1100 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë